



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 25.09.2018

Ref.: *M22/180*

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës (nr. 1523/2016, datë 20.06.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 59-të, të mbajtur më 12 shtator 2018, mori:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr. 449/16 e datës 17.08.2016 e BPrAL Kolegjit "Universi", si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr.650/16, datë 15.07.2016.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Universi" ka parashtruar kërkesë (nr. 449/16, datë: 17.08.2016) për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (nr. 650/16, datë 15.07.2016). Përmes kësaj kërkesë, Kolegji Universi ka kërkuar të rishqyrtohet: a) mos akreditimi i programit MSc Infermieri nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) si dhe b) kufizimi i numrit të studentëve për programin Infermieri/ BSc.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit "Universi" të datës 17.08.2016, dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin e KSHC-së të marrë më datë 15.07.2016.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka analizuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të dorëzuar nga Kolegji "Universi" në lidhje me mos akreditimin e programit MSc Infermieri. KSHC ka konstatuar se ky institucion nuk ka sjellë ndonjë dëshmi e cila do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të Kolegjit Universi

është trajtuar me saktësi nga ekspertja ndërkombëtare e akreditimit dhe se argumentet e ekspertës për mos akreditimin e programit të studimit janë ofruar në Raportin Final të Ekspertëve të pranuar më datë 30 Qershor 2016.

Bazuar në nenin 15, pika 3 të Ligjit të Arsimit të Lartë, sipas së cilës *“Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta”*, AKA ka vazhduar me procedurat e akreditimit sipas kërkesës së Kolegjit Universi.

Bazuar në nenin 18 pika 1, e Udhëzimi Administrativ për Akreditim Nr.02/2013, datë 16.01.2013: *“Secili ekip i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga 2-7 ekspertë të pavarur, varësisht nga madhësia e institucionit që vlerësohet”*. Bazuar mbi këtë pikë, AKA ka organizuar vizitën për vlerësim në Kolegjin Universi sipas agjendës me datë 5-6 Qershor 2016, me ekspertë ndërkombëtar për akreditim me këtë përbërje: Prof. Dr Danica Zeleznik, Prof. Dr Dusan Hamar, Prof. Stephen Adam, dhe Ms Olena Rusnak.

Nga vlerësimi i bërë, ekspertet me datë 30 Qershor 2016 kanë dorëzuar raportin final dhe rekomandimet përfundimtare për KSHC. Me datë 6 Korrik 2016 KSHC mori vendim në raport me kërkesën e Kolegjit Universi. Ky vendim është në harmoni të plotë me rekomandimet finale të ekspertëve, të dhënë në raportin final për këtë institucion.

I. Për mos rekomandim të programit të studimit Infermieri, MSc, (120 ECTS), ekspertët kanë dhënë këto sqarime:

- Sipas ekspertëve, Vizioni dhe misioni i institucionit nuk reflektojnë filozofinë e infermierisë. Është shumë i orientuar nga aspekti mjekësorë dhe duhet të rishikohet që të përfshijë filozofinë e të gjitha fushave të mësimi. Standardet akademike janë të larta por nuk reflektojnë direktivat evropiane dhe standardet e infermierisë.
- Programi është i ndare në tre profile: Profili I Edukimit të Infermiereve 120 ECTS, Profili I Menaxhimit të Infermieri 120 ECTS, Infermiera Klinike 120 ECTS. Të trija profilet përfshijnë lenden *“Teoritë e Shkencës, Filozofisë dhe Infermierisë”* e cila ligjërohet nga një doktor mjekësorë i cili nuk është i kualifikuar. Në gjithë programin vetëm një ligjërues është PhD kandidat, gjë që prapë nuk është e mjaftueshme.
- Dokumentet dhe informatat verbale të ofruara tregojnë që stafi akademik i programit duhet të jenë PhD në fushat e tyre respektive (Infermieri Edukuese, Infermieri Menaxhuese dhe Infermieri Klinike). Ky objektiv nuk është arritur dhe menaxhmenti nuk ka qene në gjendje të prezantoj një *“plan të zhvillimit”* i cili do të paraqiste përmirësimin e kësaj çështjeje në vitet e ardhshme. Për më tepër, neni 11, pika 3.2 e Udhëzimit Administrativ për akreditim Nr.02/2013, datë 16.01.2013, kërkon që të paktën gjysma e stafit akademik të jetë me kohe të plote brenda institucionit (në këtë rast do duhej të ishin infermiere me PhD). Kjo nuk tregohet në programin në fjale.

- Nga pikat e cekura me sipër, konfirmohet që Programi në Infermieri, MSc (120 ECTS) nuk i plotëson kushtet që të rekomandohet për akreditim, dhe mbi këtë bazë KSHC mori vendim për mos akreditim të këtij programi të studimit.
- II. Sa i përket kufizimit të numrit të studenteve për regjistrim ne vit akademik në programin e studimit Infermieri, BSc, (180 ECTS), ekspertët kanë dhënë këto sqarime:
- Sipas vlerësimit të ekspertëve të shprehur në raportin final, theksohet se ka mungesë të stafit akademik te fushës së infermierisë, pasi që i gjithë programi ka vetëm 2 PhD kandidat ne infermieri dhe 2 MA kandidat ne infermieri. Sipas ekspertëve “Është e qarte qe ka mungese edhe te stafit nga fusha e infermierisë me gradën Bachelor, si dhe ka nevojje për ngritjen e shkathtësive formale ne fushën e infermierisë se përgjithshme”.
 - Sipas ekspertëve, është absolutisht e nevojshme qe ne periudhën afatgjate te sigurohet staf me kualifikime akademike (me background ne infermieri). Sipas ekspertëve, shumica e stafit vjen nga shtete te tjera. Ata kane nevojje për staf kompetent lokal dhe për një strukture te qëndrueshme te stafit. Megjithatë çështja e stafit akademik te kualifikuar është një pike e dobët ne programin e infermierisë, prandaj program duhet te jete nen kontroll (monitorim) te vazhdueshëm. Bazuar në argumentet e cekura me sipër, ekspertët kanë rekomanduar që: “Numri i studenteve duhet te përshtatet me resurset ashtu siç është rekomanduar edhe me herët, dhe nuk duhet të pranohen me shume se 50 student për vit akademik. Bazuar në faktet e prezantuara me lartë, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Universi;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

